



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 16

Kontratat e ndërtimit

Qëllimi

Qëllim i këtij standardi është përshkrimi i trajtimit të të hyrave dhe të kostove në kontabilitet, të ndërlidhura me kontratat e ndërtimit. Për shkak të natyrës së aktiviteteve të ndërmarra me kontrata të ndërtimit, data në të cilën një aktivitet fillon të kryhet dhe data kur aktiviteti përfundon, zakonisht bien në periudha të ndryshme kontabël. Për këtë shkak, çështje primare në kontabilitet për sa u përket kontratave të ndërtimit është akordimi i të hyrave të kontratës dhe i shpenzimeve të kontratës për periudhat e kontabilitetit në të cilat është kryer ndërtimi. Ky standard ofron udhëzime praktike lidhur me atë se kur duhen të njihen të hyrat e kontratës dhe shpenzimet e kontratës si të hyra dhe shpenzime në pasqyrën e të ardhurave.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të aplikohet në kontabilitet për kontratat e ndërtimit në pasqyrat financiare të kontraktuesve.

Përkufizimet

2. Termat vijues janë përdorur në këtë standard me kuptime të specifikuara:

Një kontratë ndërtimi është një kontratë e shqyrtuar ndaras për ndërtim të një pasurie ose të një kombinimi të pasurive që janë të ndërlidhura ngushtë ose të ndërvarura.

Një kontratë e çmimit fiks është një kontratë e ndërtimit, në të cilën kontraktuesi pajtohet për kontratë të çmimit fiks ose të një norme fikse për njësitë e daljes (punës, prodhimit), dhe në ato raste u nënshtrohet disa herë neneve të shkallëzimit të kostos.

Një kontratë e kostos plus është një kontratë në të cilën kontraktuesi do të kompensohet për të lejueshmet ose përndryshe kostot e përkufizuara ndryshe, plus një përqindje e këtyre kostove apo një tarifë fikse.

3. Një kontratë ndërtimi mund të diskutohet për ndërtim të një pasurie të vetme, siç është një urë, ndërtesë apo një rrugë. Një kontratë ndërtimi gjithashtu mund të merret me ndërtimin e një numri të pasurive që janë ngushtë të ndërlidhura ose të ndërvarura sa i përket disenjit dhe funksionit të qëllimit apo të përdorimit të tyre themelor; shembuj të kontratave të këtilla përfshijnë ato kontrata të ndërtimit të pjesëve të bllokut të një impianti ose pajisjeje.
4. Për qëllime të këtij standardi, kontratat e ndërtimit përfshijnë:
 - a) kontratat për kryerjen e shërbimeve që janë të lidhura drejtpërdrejt me ndërtimin e një pasurie, për shembull, ato për shërbime të menaxherëve dhe të arkitektëve të projektit;
 - b) kontratat për shkatërrimin ose restaurimin e një pasurie dhe restaurimin e ambientit krahas demolimit të pasurive.
5. Kontratat e ndërtimit janë të formuluar në shumë mënyra që për qëllime të këtij standardi, janë klasifikuar si kontrata të çmimit të fiksuar dhe kontrata të kostos plus.

Kombinimi dhe segmentimi i kontratave të ndërtimit

6. Kërkesat e këtij standardi zakonisht zbatohen ndarazi për secilën kontratë të ndërtimit. Sidoqoftë, në rrethana të caktuara, është e nevojshme që të zbatohet standardi për përbërësit e ndarë të identifikueshëm të një kontrate të vetme ose të një grupi të kontratave së bashku, në mënyrë që të reflektojë përmbajtjen e një kontrate ose të një grupi të kontratave.
7. Kur një kontratë lidhet për një numër të pasurive, ndërtimi i secilës pasuri duhet të trajtohet si një kontratë e ndarë e ndërtimit kur:
 - (a) për secilën pasuri janë dorëzuar propozime të ndara

- (b) secila pasuri u është nënshtruar diskutimeve të ndara si edhe kontraktuesi dhe konsumatori kanë qenë në gjendje të pranojnë ose të refuzojnë atë pjesë të kontratës që është në lidhje me secilën pasuri, dhe
- (c) mund të identifikohen kostot dhe të hyrat e secilës pasuri

Shembull i segmentimit të kontratës

Një kontraktorë ndertimi dhe një konsumator kanë nënshkruar një kontratë e cila përmbanë dy gjëra të ndryshme pompë benzine dhe restaurant mirëpo në të njejtën tokë. Kontraktori do të bejë ndertimin e të dy objekteve me propozime te ndryshme. Edhe pse është nënshkruar vetëm një kontratë secila pasuri duhet te trajtohet ne menyre te vecant për nevoja të këtij standardi.

8. Një grup i kontratave, pa marrë parasysh nëse kanë të bëjnë me një konsumator të vetëm apo me disa konsumatorë, duhet të trajtohen si një kontratë e vetme e ndërtimit kur:
 - (a) grupi i kontratave është diskutuar si një paketë e vetme;
 - (b) kontratat janë të ndërlidhura aq ngushtë sa që, në efekt, janë pjesë e një projekti të vetëm me një margjinë të fitimit të gjithmbarshëm, dhe
 - (c) kontratat janë kryer njëkohësisht ose në sekuenca të vazhdueshme..

Shembull i kombinimit të kontratës

Një kontraktorë dhe konsumatorë kanë nënshkruar një kontratë për ndërtimin e dy ndërtesave të cilat gjenden njëra pran tjetrës. Edhe pse është bërë nënshkrimi i dy kontratave të vecanta, negociatat janë bërë për të dy ndërtesat në të njejtën koha. Edhe pse është bërë nënshkrimi i dy kontratave, duhet të bëhet kombinimi i tyre për nevoja të këtij standardi.

Të hyrat e kontratës

9. Të hyrat e kontratës duhet të përbëhen nga:
 - (a) shuma fillesare e të hyrave siç është pajtuar me kontratë, dhe
 - (b) variacionet në punë të kontraktimit, kërkesat dhe pagesat stimuluuese:
 - (i) deri në atë masë sa është e mundshme që ato të rezultojnë në të hyra, dhe
 - (ii) ato janë të afta që të maten me besueshmëri

10. Të hyrat e kontratës maten në vlerën e tyre fer të konsideruara si të pranuar apo të arkëtueshme. Matja e të hyrave të kontratës ndikohet nga një varietet i të papriturave që varen nga përfundimi i ngjarjeve të ardhshme. Supozimet zakonisht duhet rishikuar si ngjarje që ndodhin dhe të papritura që janë rizgjidhur. Prandaj, shuma e të hyrave të kontratës mund të rritet ose të zvogëlohet prej një periudhe në tjetrën. Për shembull:
 - (a) një kontraktues dhe një konsumator mund të pajtohen në shumë variacione apo kërkesa që i shtojnë apo i zvogëlojnë të hyrat e kontratës për periudhën si pasojë e marrëveshjes që është arritur në kontratë fillimisht;
 - (b) shuma e të hyrave të kontratës mund të zvogëlohet si rezultat i dënimeve që dalin nga vonesat e shkaktuara prej kontraktuesit gjatë kompletimit të kontratës.

11. Një variacion është një udhëzim nga konsumatori për ndryshime në fushëveprimin e punës që duhet të kryhet gjatë kontratës. Një variacion mund të krijojë rritje apo zvogëlim në të hyrat e kontratës. Shembujt e variacioneve janë ndryshimet në specifikacionet apo disenjime të pasurive dhe ndryshimet në kohëzgjatjen e kontratës. Një variacion mund të përfshihet në të hyra të kontratës kur:
 - (a) është e mundshme që konsumatori ta aprovojë variacionin dhe shumën e të hyrave që rrjedhin prej atij variacioni, dhe
 - (b) shuma e të hyrave që mund të matet me besueshmëri

12. Një kërkesë është një shumë që kontraktori e kërkon ta mbledhë prej klientit ose ndonjë pale tjetër si një kompensim për kostot që nuk janë përfshirë në çmimin e kontratës. Për shembull, një kërkesë mund të ngritet kur klienti shkakton vonesa, ka gabime në specifikim apo disenj

dhe variacione të diskutuara në punën kontraktore. Matja e shumave të të hyrave që rrjedhin nga kërkesat i nënshtrohet një niveli të lartë të pasigurisë dhe shpesh varet nga përfundimi i diskutimeve. Prandaj, kërkesat janë të përfshira në kontratë vetëm kur:

- (a) diskutimet kanë arritur një nivel më të avancuar, ashtu që është e mundshme që klienti ta pranojë kërkesën, dhe
 - (b) shuma, e cila supozohet se do të pranohet nga klienti, mund të matet me besueshmëri.
13. Pagesat e stimulimit janë shumat që i ka paguara kontraktuesit nëse standardet e specifikuara të punës janë arritur ose janë tejkalluar. Për shembull, një kontratë mund të lejojë për një pagesë stimuluese ndaj kontraktuesit për përmbushjen e mëhershëm të kontratës. Pagesat stimuluese përfshihen në të hyrat e kontratës kur:
- (a) kontrata është aq e avancuar sa që është e mundshme që standardet e specifikuara të punës të arrihen apo të tejkallohen, dhe
 - (b) shuma e pagesës stimuluese mund të matet me besueshmëri

Kostot e kontratës

14. Kostot e kontratës duhet të përmbajnë:
- (a) kostot që janë të lidhura drejtpërdrejt me kontrata specifike
 - (b) kostot që janë të atribuueshme ndaj aktivitetit të kontratës në përgjithësi dhe që mund të akordohen me kontratë, dhe
 - (c) kostot e tjera që në mënyrë specifike i ngarkohen klientit, sipas kushteve të kontratës.
15. Kostot që janë të lidhura drejtpërdrejt me një kontratë specifike, përfshijnë:
- (a) kostot e fuqisë punëtore në punishte, përfshirë mbikqyrjen e punishtes;
 - (b) kostot e materialeve të përdorura në ndërtim
 - (c) amortizimi i impianteve dhe pajisjeve të përdorura në kontratë

- (d) kostot e lëvizjes së impianteve, pajisjeve dhe materialeve në punishtë dhe prej punishtes së kontratës;
- (e) kostot e huazimeve të impiantëve dhe pajisjeve të përdorura në kontratë;
- (f) kostot e disenjit dhe të ndihmës teknike që janë të lidhura drejtpërdrejt me kontratën.

Këto kosoto mund të redukohen me një të ardhur të rastit që nuk është e përfshirë në kontratë të të hyrave, për shembull të ardhurat prej shitjeve të materialit tepricë dhe të largimit të impiantëve dhe pajisjeve në fund të kontratës.

16. Kostot që mund t'u atribuohen aktiviteteve të kontratës dhe mund të akordohen në kontrata specifike, përfshijnë:

- (a) sigurimin;
- (b) kostot e disenjit dhe të ndihmës teknike, që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me kontratat specifike, dhe
- (c) shpenzime të përgjithshme karakteristike.

Kostot e këtilla janë të përndara duke i zbatuar metodat që janë sistematike dhe racionale dhe që janë aplikuar në mënyrë konsekuente për të gjitha kostot që kanë karakteristika të ngjashme. Akordimi është e bazuar në nivelin normal të aktiviteteve të ndërtimit. Shpenzimet e përgjithshme karakteristike të ndërtimit përfshijnë kostot, si ato të përgatitjes dhe procesit të përpunimit të pagesave të personelit të ndërtimit.

17. Kostot që u ngarkohen në mënyra specifike klientëve sipas kushteve të kontratës, mund të përfshijnë disa kosto të përgjithshme administrative dhe kosto të zhvillimit, për të cilat kompensimi është specifikuar në kushtet e kontratës.

18. Kostot që nuk mund të jenë të atribueshme ndaj aktiviteteve të kontratës ose nuk mund të akordohen duhet të hiqen nga kostot e kontratës së ndërtimit. Kostot e tilla duhet të përfshijnë:

- (a) kostot e përgjithshme për të cilat kompensimi nuk është caktuar në kontratë;
- (b) kostot e shitjes;

- (c) kostot e kërkimit dhe zhvillimit, për të cilat kostot e kompensimit nuk janë të specifikuara në kontratë, dhe
 - (d) amortizimin e impianteve dhe pajisjeve joaktive që nuk janë përdorur në një kontratë të veçantë.
19. Kostot e kontratës duhet t'i përfshijnë kostot e atribueshme ndaj kontratës për një periudhë prej datës së sigurimit të kontratës deri në kompletimin përfundimtar. Sidoqoftë, kostot që janë të lidhura drejtpërdrejt me kontratën dhe të cilat bëhen gjatë sigurimit të kontratës janë të përfshira gjithashtu si pjesë e kostove të kontratës, nëse mund të identifikohen ndarazi dhe të maten me besueshmëri dhe është e mundshme që kontrata të realizohet. Kur kostot që janë bërë gjatë sigurimit të kontratës, të jenë njohur si një shpenzim në periudhën në të cilën ato kanë ndodhur, ato nuk përfshihen në kostot e kontratës, kur më kontrata realizohet në një periudhë pasuese.

Njohja e të hyrave dhe e shpenzimeve të kontratës

20. Kur rezultatet e një kontrate të ndërtimit mund të vlerësohen me besueshmëri, të hyrat dhe shpenzimet e kontratës lidhur me kontratën e ndërtimit duhet të njihen përkatësisht si të hyra dhe shpenzime sipas referimit të shkallës së kompletimit të aktiviteteve të kontratës në pasqyrën e bilancit. Një humbje e pritur në kontratën e ndërtimit duhet të njihet menjëherë.
21. Në rast të kontratës së çmimit fiks, rezultatet e kontratës së ndërtimit mund të vlerësohen me besueshmëri, kur të plotësohen të gjitha kushtet vijuese:
- (a) të hyrat e gjithmbarshme mund të maten me besueshmëri;
 - (b) është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me kontratën do të rrjedhin për në ndërmarrje;
 - (c) që të dyja, kostot e kontratës që të kompletohet kontrata dhe shkalla e kompletimit të kontratës në datën e pasqyrës së bilancit mund të maten me besueshmëri, dhe
 - (d) kostot e kontratës të atribueshme ndaj kontratës mund të identifikohen me qartësi dhe mund të maten me besueshmëri, kështu që kostot aktuale që kanë ndodhur mund të krahasohen me vlerësimet e mëparshme.

22. Në rast të kontratës së kostos plus, rezultatet e kontratës së ndërtimit mund të maten me besueshmëri, kur të jenë plotësuar të gjitha kushtet vijuese:
- (a) është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me kontratën do të rrjedhin në ndërmarrje, dhe
 - (b) kostot e kontratës të atribueshme ndaj kontratës, pa marrë parasysh nëse a janë apo nuk janë të kompensueshme në mënyrë specifike, mund të identifikohen qartë dhe të maten me besueshmëri.
23. Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve sipas një referimi tek shkalla e kompletimit të kontratës, zakonisht referohet si një metodë e përqindjes së kompletimit. Sipas kësaj metode të hyrat e kontratës përputhen me kostot e kontratës që kanë ndodhur gjatë arritjes së shkallës së kompletimit, me rezultatet në raportimin e të hyrave, shpenzimeve dhe të fitimit që mund t'i ngjitet pjesës së punës së kompletuar. Kjo metodë ofron informata të rëndësishme për kohëzgjatjen e aktivitetit të kontratës dhe të punës gjatë një periudhe.
24. Sipas metodës së përqindjes së kompletimit, të hyrat e kontratës njihen si të hyra në pasqyrën e të ardhurave në periudhat e kontabël në të cilat është kryer puna. Kostot e kontratës njihen zakonisht si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave lidhur me periudhat kontabël në të cilat është kryer puna. Sidoqoftë, çfarëdo tejkalimi i pritur i kostove totale përmbi të hyrat totale të kontratës, sa i përket kontratës, njihet menjëherë si një shpenzim.
25. Një kontraktor mund të ketë pasur shpenzime të kontratës që janë në lidhje me aktivitetet e ardhshme të kontratës. Kostot e këtilla njihen si një pasuri e siguruar dhe është më se e mundshme ato do të mbulohen. Kostot e këtilla e paraqesin një shumë të duhur prej konsumatorit dhe shpesh klasifikohen si punë në përparim.
26. Rezultatet e një kontrate të ndërtimit mund të vlerësohen me besueshmëri vetëm atëherë kur është e mundshme që fitimet e ardhshme ekonomike që i përkasin kontratës, të derdhen në ndërmarrje. Sidoqoftë, kur të kemi pasiguri për mbledhjen e një shume tashmë të përfshirë në të hyrat e kontratës dhe tashmë të njohur në pasqyrën e të ardhurave, shuma e pambledhur ose shuma me të cilën mbulimi ka përfunduar së qeni i mundshëm, njihet si një shpenzim në vend të njohjes si një përmirësim i shumës së të hyrave të kontratës.
27. Një ndërmarrje në përgjithësi ka mundësi që të bëjë vlerësime të besueshme pasi të jetë pajtuar me një kontratë që themelon:

- (a) të drejtat e zbatueshme të secilës palë lidhur me pasurinë që duhet të ndërtohet,
- (b) konsideratat që duhet të këmbehen, dhe
- (c) mënyrën dhe rregullat e themelimit.

Po ashtu, zakonisht është e nevojshme për ndërmarrjen që ketë një sistem efektiv të brendshëm financiar të buxhetit dhe të raportimit. Ndërmarrja i rishikon dhe kur është e nevojshme i rishqyrton vlerësimet e të hyrave të kontratës dhe kostove të kontratës si përparime të kontratës. Nevoja për rishqyrtime të tilla nuk tregon doemos se rezultatet e kontratës nuk mund të vlerësohen me besueshmëri.

28. Niveli i kompletimit të një kontrate mund të përcaktohet në shumë mënyra. Ndërmarrja përdor metodën që e mat me besueshmëri punën që është punuar. Varësisht nga natyra e kontratës metodat mund të përfshijnë:
- (a) përpjesëtimi në kosto të shkaktuara të kontratës për punën e kryer deri më tani u bashkohet kostove totale të kontratës,
 - (b) ekspertizën e punës së kryer, ose
 - (c) kompletimin e përpjesëtimit fizik të punës së kryer kontraktuese.

Pagesat në vazhdim dhe pagesat në paradhënie të pranuar prej konsumatorëve, shpesh nuk pasqyrojnë punën e kryer.

29. Kur niveli i kompletimit është përcaktuar prej referimit të kostove të kontratës, vetëm ato kosto të kontratës që pasqyrojnë punën e kryer janë të përfshira në kostot e krijuara deri më tani. Shembujt e kostove të kontratës që janë të përjashtuara janë:
- (a) kostot e kontratës që nuk përkojnë me aktivitetet e ardhshme të kontratës, siç janë kostot e materialeve që kanë qenë të dërguara tek kontraktori ose janë të vendosura anash për t'u përdorur në kontratë por nuk janë instaluar ende, kanë qenë të përdorura apo të zbatuara gjatë performansës së kontratës, përveç nëse materialet janë të bëra në mënyrë specifike për atë kontratë; dhe
 - (b) pagesat e bëra tek nënkontraktuesit në paradhënie për punën e kryer prej nënkontratës.

30. Kur rezultatet e një kontrate të ndërtimit nuk mund të maten me besueshmëri:

- (a) të hyrat duhet të njihen vetëm deri në atë nivel në të cilin të dalat e ngjara të kontratës do të mund të të rikuperohen;
 - (b) të dalat e kontratës duhet të njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato ngjajnë.
 - (c) një humbje e pritur në kontratën e ndërtimit duhet të njihet menjëherë si një shpenzim.
31. Gjatë fazave të hershme të kontratës shpesh ndodh që rezultati i kontratës nuk mund të matet me besueshmëri. Sidoqoftë, është e mundshme që ndërmarrja do të rikuperoj të dalat që kanë ngjarë me kontratë. Prandaj, e hyra nga kontrata njihet vetëm në nivelin e të dalave të ngjara të cilat mund të rikuperohen. Pasi që rezultati nga kontrata nuk mund të matet me besueshmëri, fitimi nuk njihet. Në rastet tjera, megjithëse rezultatet e kontratës nuk mund të maten me besueshmëri, mund të ketë gjasa që të dalat e gjithmbarshme të kontratës të tejkalojnë të hyrat e kontratës. Në raste të tilla, çfarëdo tejkalimi i pritur i të dalave të gjithmbarshme të kontratës ndaj të hyrave të gjithmbarshme në kontratë njihen menjëherë si shpenzime.
32. Të dalat e kontratës rikuperimi i të cilave nuk është i mundshëm njihen menjëherë si shpenzime. Shembuj të rrethanave në të cilat nuk është i mundshëm rikuperimi i të dalave të kontratës dhe në të cilat të dalat e kontratës duhet të njihen menjëherë si shpenzime përfshijnë kontratat:
- (a) të cilat nuk janë plotësisht të plotëfuqishme, do të thotë, vlefshmëria e kontratës vihet në pyetje seriozisht
 - (b) përmbushja e së cilës u nënshtrohet rezultateve të çështjeve të pazgjidhura gjyqësore apo ligjore
 - (c) ku konsumatori nuk mund t'i përmbush obligimet, ose
 - (d) ku kontraktori nuk mund të përmbush kontratën ose përndryshe përmbushë obligimet e kontratës.
33. Kur paqartësitë të cilat kanë parandaluar vlerësimin e besueshëm të rezultateve të kontratës nuk ekzistojnë më, të hyrat dhe shpenzimet e lidhura me kontratën e ndërtimit do të duhej të njihen sipas paragrafit 20.

Njohja e humbjeve të parapara

34. Kur është e mundshme që të dalat e gjithmbarshme të kontratës të tejkalojnë të hyrat e gjithmbarshme të kontratës, humbjet e parapara do të duhej të njihen menjëherë si shpenzime.
35. Shuma e humbjeve të tilla përcaktohet pavarësisht:
- (a) se a ka filluar apo jo puna e kontraktuar
 - (b) prej shkallës së përmbushjes së aktiviteteve të kontraktuara

Ndryshimet në vlerësime

36. Përqindja e metodës përmbushëse zbatohet në baza kumulative në çdo periudhë kontabël për vlerësimet vijuese të të hyrave të kontratës dhe të dalave të kontratës. Prandaj, efektet e një ndryshimi në vlerësimin e të hyrave të kontratës ose të dalave së kontratës, ose efektet e ndryshimit në vlerësimin të rezultatit të një kontrate, llogaritet sikur ndryshim në vlerësimin kontabël (Shih SKK 5 “Fitimi ose humbja neto për periudhën, zërat e jashtëzakonshëm, gabimet fundamentale, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe ndryshimet në politikat kontabël”). Vlerësimet e ndryshuara janë përdorur në përcaktimin e shumës së të hyrave dhe shpenzimeve të njohura në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën është bërë ndryshimi si dhe në periudhat pasuese.

Shpalosja

37. Një ndërmarrje duhet të shpalosë:
- (a) shumën e të hyrave të kontratës e njohur si e hyrë për periudhën;
 - (b) metodat e përdorura për përcaktimin e të hyrave të kontratës për periudhën; dhe
 - (c) metodat e përdorura për përcaktimin e shkallës së përmbushjes së kontratës në vazhdim .
38. Një ndërmarrje duhet të shpalosë secilën nga pikat vijuese për kontratat në vazhdim në datën e pasqyrës së bilancit;
- (a) shumën e gjithmbarshme të të dalave që kanë ngjarë dhe fitimeve të njohura (minus humbjet e njohura) deri tani;
 - (b) shumën e paradhënieve të arkëtuara; dhe
 - (c) shumën e mbajtjeve

39. Mbjatjet janë shumë të faturimeve në vijim të cilat nuk paguhen përdërisa nuk përmbushen kushtet e specifikuar në kontratë për pagesat e shumave të tilla ose përdërisa nuk rregullohen defektet . Faturimet në vijim janë shumë të faturuara për punën e bërë në kontratë pa marrë parasysh se a e ka paguar konsumatori apo jo. Paradhëniet janë shumë të arkëtuara nga kontraktori para se të kryhet puna e përkatëse.
40. Një ndërmarrje duhet të prezentoj
- (a) shumën bruto të borxhit prej konsumatorit për punën në kontratë si pasuri; dhe
 - (b) shumën bruto të borxhit ndaj konsumatorit për punën në kontratë si detyrim
41. Një ndërmarrje duhet të shpallë çfarëdo detyrime kontingjente dhe pasuri kontingjente sipas SKK 17 “Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente”. Detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente mund të rrjedhin prej zërave siç janë paditë, gjobat ose humbjet e mundshme.

Data e hyrjes në fuqi

42. Ky standard do të hyjë në fuqi për pasqyrat financiare që u përkasin periudhave prej 1 janari 2002 dhe më pas tyre. Rekomandohet zbatimi i mëhershëm i këtij standardi.

Shtojcë

Kjo shtojcë është vetëm ilustrim dhe nuk është pjesë e standrardit. Qëllimi i standardit është që të ilustrojë zbatimin e standardit në mënyrë që të ndihmojë në sqarimin e domethëniesë së tij.

Shembulli në vijim ilustron një metodë të përcaktimit të shallës së përmbushjes së një kontrate si dhe koordinimin e njohjes së të hyrave dhe shpenzimeve të kontratës.

Një kontraktor ndërtimor ka kontratë të çmimit fiks për 250,000 DM për të ndërtuar një urë. Shuma fillestare e të hyrave të miratuara është 250,000 DM. Vlerësimi fillestar i të dalave të kontratës së kontraktorit është 150,000 DM. Ndërtimi i urës do të bëhet në vitet 2002 dhe 2003.

Kontraktori përcakton shkallën e përmbushjes së kontratës duke llogaritur përpjesëtimin e të dalave që kanë ngjarë me kontratë për punën e bërë deri tani të regjistruar me të dalat e gjithmbarshme të vlerësuara të kontratës. Një përmbledhje e të dhënave financiare gjatë periudhës së ndërtimit është si vijon:

	2002	2003
Shuma fillestare e të hyrave e miratuar në kontratë	250,000	250,000
	90,000	150,000
Të dalat e ngjara të kontratës deri më tani		
Të dalat e kontratës për përmbushje	60,000	
Të dalat e gjithmbarëshme të vlerësuara të kontratës ¹⁵⁰	150,000	150,000
Fitimi i vlerësuar	100,000	100,000
Shkalla e përmbushjes	60%	100%

Shumat e të hyrave, shpenzimeve dhe fitimeve të njohura në pasqyrën e të ardhurave në dy vjetët janë si vijon:

	Deri tani	<u>Të njohura vitin paraprak</u>	<u>Të njohura në vitin kurrent</u>
<u>2002</u>			
Të hyrat (250,000 x 60%)	150,000		150,000
Shpenzimet (150,000 x 60%)	90,000		90,000
Fitimi	60,000		60,000
	250,000	150,000	100,000
<u>2003</u>	150,000	90,000	60,000
Të hyrat			
Shpenzimet			40,000
Fitimi	100,000	60,000	